

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me procesëmbajtësen Nexhmije Abazxhik, në konfliktin administrativ, të paditësit F. shpk nga P. kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: rivlerësim i mallit doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 06.10.2015, në prani të autorizuarit të paditësit, e në mungesë të autorizuarës së paditurës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit F. shpk nga P., si e bazuar.

ANULOHET aktvendimi nr.05.2.1/155,301 datës 24.03.2014 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që si bazë në rillogaritje për zhdoganimin e mallit lëndor sipas DUD-ave R 2633/07.02.2014, R2954/12.02.2014 dhe R2959/12.02.2014 të Zyrës doganore Hani i Elezit, të merr vlerën e deklaruar të transaksionit realisht të paguar sipas faturave përcjellëse nr.14/06022014, 16/10022014, 15/07022014, duke shtuar mbi këtë bazë shpenzimet e lejueshme si dhe t,ia rikthej paditësit F.shpk nga P., detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese.

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit, për rishqyrtimin e vendimeve R 2633/07.02.2014, R2954/12.02.2014 dhe R2959/12.02.2014 të Zyrës doganore Hani i Elezit.

Paditësi F. shpk nga P. me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 22.04.2014, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditues Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata aprovimin në tërësi të padis, të anulohet vendimi nr.05.2.1/155, 301 dt.24.03.2014 i Doganës së Kosovës.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar, në seancën publike, paditësi deklaroi: Dogana e Kosovës ka marrë metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, por me asnjë dokument nuk sqaron se nga janë marrë ato çmime të vlerësimit duke mos lëshuar së paku një procesverbal të vetëm se ku janë verifikuar ato çmime. Ne kemi prezantuar dokumentacionin e blerjes së mallit të kompletuar duke ju përkujtuar se malli i importuar është me origjinë nga Bullgaria, vend anëtar i Bashkimit Evropë ku mundësia e deformimeve në faturë është inekzistente dhe e pamundur. Prandaj ne si importues serioz konstatojmë se çmimi i marrë nga e paditura Dogana e Kosovës është i padrejtë por edhe këtu nuk analizohet fare neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Bazuar në këtë dispozite ligjore kam paraqitur vlerën reale të transaksionit dhe atë pra me çmimin e paguar, të njëjtin e kam dokumentuar me të gjitha dëshmitë e mundshme pra kam prezantuar faturën origjinale, deklaratën eksportuese, CMR, kontratën e shitblerjes sipas kërkesës së Doganës së Kosovës si dhe transferet bankare mbi pagesën e mallrave të blera në vendin e origjinës së mallrave-Bullgari, kontrata e vërtetuar nga Oda Ekonomike në Bullgari. Gjatë zhdoganimit të mallit unë kam shpreh gatishmërinë që në Doganën e Kosovës të sjell edhe çdo dokument tjetër i cili do të ishte i nevojshëm me të vetmen arsye që të dokumentoj se kjo është vlera reale e paguar për mallin të cilin e importoj, mirëpo Dogana e Kosovës vetëm e ka ngritur vlerën për 100% të vlerës që konsiderojmë se nuk është fare e bazuar me konstatimin se çmimi nuk është real pa e elaboruar se përse nuk është real dhe së paku të sjell një

dëshmi apo procesverbal të vetëm se ku janë marrë çmimet e tilla për vërtetimin e gjendjes faktike Dëshmi bindëse është aktvendimi 05.2.1/54 i datës 30.01.2014 me të cilin aktvendim aprovohet ankesa jonë drejtuar Doganës së Kosovës, ndërsa pas dy ditësh për të njëjtin mall të importuar nga i njëjti furnitor dhe i njëjti shtet i origjinës-Bullgari ngritet vlera e mallit me të njëjtin arsytim në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

E paditura përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigjen në padi datës deklaroi: Dogana e Kosovës vërteton se rivlerësimi i mallrave është në harmoni të plotë me të dhënat e disponueshme që janë marrë nga sektori i vlerës, vlerësim ky i cili është bërë në bazë të çmimit të shitjes në tregun tonë, e bazuar në këto informata janë përpiluar edhe çmimet për mallin lëndor të cilat konsideron mjaft të besueshme. Dogana e Kosovës i konsideroj si jo relevante pretendimet e paditësit dhe nuk e konsideron të nevojshme të lëshohet në administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të deklaruar në kuptim të konstatimit të vërtetësisë dhe saktësisë së tij meqenëse ekziston një shkresë nga sektori i vlerës e cila në mënyrë të qartë dhe decisive ka caktuar çmimet për mallin kontestues. Për këto arsye Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli lëndor nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, andaj i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 06.10.2015, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt.13.02 2015 nga Ministria e Drejtësisë, aktvendimi nr.05.2.1/155,301dt.24.03.2014 nga Dogana e Kosovës, kontrata e shitblerjes, Deklaratat unike doganore R2633/07.02.2014, R2954/12.02.2014, R2959/12.02.2014 të Zyrës Doganore Hani i Elezit, fakturat përcjellëse, urdhërpagesat ndërkombëtare, procesi për përcaktimin e vlerës së mallit dt.12.02.2014 nga Zyra Doganore Hani i Elezit, deklaratat eksportuese, fakturat tatimore dt.19.02.2014, aktvendimi nr. 05.2.1/54 dt.30.01.2014 nga Dogana e Kosovës.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe konstatoi se kërkespadija është e bazuar.

Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura nuk ka dhënë asnjë arsye pse ka kontestuar vlerën e mallit lëndor si dhe dokumentacionin përcjellës të dorzuar nga paditësi në procedurën administrative të ankesave dhe në këtë konflikt administrativ sikurse që janë: deklaratat eksportuese e shtetit eksportues MRN14BG003000A0019182, MRN14BG003000A0019653 dhe MRN14BG003000A0018343 të lëshuara nga shteti i Bullgarisë, urdhërpagesat ndërkombëtare dt.11.02.2014, 21.02.2014, 13.03.2014 të paguara në P.C. B. të cilat përmbajnë shënimet për furnitorin e njëjtë A. P.-Bullgari, numrin e njëjtë të faturave përcjellëse të mallit lëndor të deklaruar me rastin e zhdoganimit të mallit, vlera e të cilave harmonizohet me vlerën e deklaruar të mallit lëndor të zhdoganuar me DUD-at kontestues dhe faturat përcjellëse, kontrata e shitblerjes e lidhur mes paditësit dhe furnizuesit të mallit me datë 13.01.2014. Siç shihet edhe në vendimin kontestues e paditura i ka poseduar të gjitha këto prova në procedurën administrative kur ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të paditësit, mirëpo asnjërin prej këtyre provave të prezantuara nuk e ka shqyrtuar, obligim ky që rrjedh me dispozitat legjislativë doganore.

E paditura në arsyetimin e vendimit kontestues jep konstatimin se nuk e konsideron të nevojshëm të lëshohet në administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të deklaruar në kuptim të konstatimit të

vërtetësisë dhe saktësisë së tij, meqenëse ekziston një shkresë nga sektori i vlerës e cila ka caktuar çmimet për mallin kontestues.

Gjykata konsideron se e paditura nuk ka mundur të aplikoj metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, duke arsyetuar me një shkresë të sektorit të vlerës e datës 05.02.2014, si referencë që ka shërbyer për rivlerësim të mallit si e dhënë e disponueshme, për arsye se para se të aplikoj metodën e gjashtë të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme që disponon, e paditura është dashur ti arsyetoj shkaqet e mosaplikimit të metodave paraprake të vlerësimit nga neni 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, e që në këtë rast siç shihet nga arsyetimi i vendimit të kontestuar e paditura nuk është lëshuar fare në vlerësimin e dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor të cilin e ka prezantuar paditësi edhe në procedurën administrative të ankesave, prandaj një arsyetim i tillë me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit pa dhënë arsyetim lidhur me kërkesën e paditësit për të shqyrtuar dokumentacionin përcjellës të mallit, është në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 85 të Ligjit 02/L-28 për Procedurën Administrative. Gjykata vlerëson se e paditura është dashur të vlerësoj validitetin e dokumentacionit të mallit lëndor në kuptimin e vlerës për të vërtetuar se a është vlera e deklaruar vlerë e paguar e transaksionit siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109.

Gjykata nuk mund ti konsideroj se të dhënat e disponueshme paraqesin argumente të bazuara për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që paraprakisht duhet të kontestohet rregullsia ligjore e ndonjë dokumenti përcjellës të mallit lëndor i cili i referohet çmimit të faturës në vështrim të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.3/2004 për zbatimin e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Asnjë dispozitë ligjore nga neni 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk parasheh se vlera e deklaruar e mallit sipas dokumentacionit përcjellës nuk pranohet në rastet kur Dogana disponon me të dhëna me çmime më të larta të mallit të ngjashëm apo identik në periudhë të afërt kohore. Përfundimisht nga kjo kanë të bëjnë shitjet mes personave të lidhur në vështrim të nenit 33.2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, e që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një shitje të këtillë. Nga shkresat e lëndës gjykata vëren se e paditura në periudhë të afërt kohore, me aktvendimin 05.2.1/54 datës 30.01.2014 ia ka pranuar paditësit dokumentacionin përcjellës të njëjtë të deklaruar nga i njëjti eksportues me DUD-at 167.17.01.2014, 646/14.01.2014, duke pranuar vlerën e paguar të transaksionit në vështrim të nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ndërsa tani në rastin konkret për importet e realizuara vetëm një muaj më vonë për mallin e ngjashëm nga i njëjti eksportues, e paditura e refuzon dokumentacionin e njëjtë të prezantuar nga paditësi për mallin lëndor të zhdoganuar me DUD-at kontestues.

Gjykata konstaton se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara e të drejta, dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikpamja ligjore për zhdoganimin e mallit konform dispozitave të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, duke shtuar mbi këtë bazë edhe shpenzimet e lejueshme konform nenit 36 dhe 37 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, andaj e obligon të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit F. shpk nga P., t,ia rikthejë detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ATK dhe Procedurat nr.03/-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.545/14 datë 06.10.2015

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.